




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Sektori i Sportit do të bëjë zgjedhjen e laureatëve të dalluar në sport për vitin 2024.

N J O F T I M

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, njofton të gjitha organizatat e regjistruara si OJQ, Klube apo Shoqata Sportive, që t'i dërgojnë propozimet e tyre për zgjedhjen e sportistëve më të mirë, të cilët duhen të bëhen ekskluzivisht nëpërmjet Klubeve Sportive.

Propozimet bëhen për: **Sportistin, Trajnerin, Klubin, Shpresën e vitit** si dhe **Punëtorin Sportiv më të mirë**.

Gjatë propozimit për laureatë, në mënyrë të qartë duhet të përshkruhet aktiviteti i secilit sportist dhe të specifikohet pjesëmarrja në garat ekipore dhe individuale si p.sh. (Diplomat, Medaljet, Certifikatat, Arritjet, etj) në të cilat kanë garuar sportistët, klubet dhe sukseset të cilat i kanë arritur në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë gjatë vitit 2024.

Propozimet për zgjedhjen e laureatëve më të mirë mund të bëhen përmes klubeve sportive dhe të dorëzohen fizikisht në Sektorin e Sportit – Pallati i Sporteve “Shani Nushi”

Rr. “Tirana”, p.n. 50 000 Gjakovë, më së largu deri më datën **10.01.2025 ora: 16:00**

Përzgjedhja e më të mirëve do të bëhet nga Komisioni i themeluar për këtë qëllim.

Më poshtë gjeni formularin për aplikim!

Me respekt!

Labinot Efendiu

Udhëheqës i Sektorit të Sportit

Laureati për Vitin 2024

Klubi – Shoqata: _____

Shënoni sukseset e kandidatëve të propozuar për këtë vit.

1. SPORTISTI: _____

2. TRAJNERI: _____

3. KLUBI MË I MIRË: _____

4. SHPRESA E VITIT: _____

5. PUNËTORI SPORTIV: _____

Kryetari i Klubit:
